



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.Dh.Sh.II.nr.74/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit N.T.P “Plus” me seli në Prishtinë ndaj debitorit “Candeo” L.L.C. me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, PPP.nr.725/18 të datës 31.10.2018, me datë 21.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET ankesa e debitorit Candeo L.L.C, me seli në Prishtinë, NDRYSHOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, PPP.nr.725/18 i datës 31.10.2018, ashtu që çështja gjykohet si në vijim:

APROVOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Candeo L.L.C, me seli në Prishtinë, i ushtruar kundër Urdhrit mbi lejimin e përmbarimit P.nr.387/18 datës 04.06.2018, të lejuar nga Zyra përmbarimore-përmbaruesi privat Rrezarta Metaj në Prishtinë, ANULOHET Urdhri përmbarimor P.nr.387/18 i datës 04.06.2018 i lejuar nga Zyra përmbarimore-përmbaruesi privat Rrezarta Metaj në Prishtinë.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me aktvendimin PPP.nr.725/18 të datës 31.10.2018, e ka Refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit “Candeo” L.L.C me seli në Prishtinë, i ushtruar kundër urdhrit për lejimin e përmbarimit numër P.nr.387/18 të datës 04.06.2018 të lejuar nga Zyra Përmbarimore – përmbaruesi privat Rrezarta Metaj në Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori “Candeo” L.L.C me seli në Prishtinë, përmes përfaqësuesit të autorizuar SH.A. Sejdiu&Qerkini në Prishtinë, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, me propozim që të aprovohet ankesa e debitorit Candeo ShPK si e bazuar, të anulohet Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, PPP.nr.725/18 të datës 31.10.2018, si i paligjshëm dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje dhe gjykata e shkallës së parë të obligohet të caktoj seancën gjyqësore.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

- Ankesa e debitorit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori N.T.P “Plus” me seli në Prishtinë me datën 04.06.2018, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit Candeo L.L.C, me seli në Prishtinë, në bazë të dokumenteve të përmbartueshme faturave nr.17-210-001-249 datë 06.06.2017, fatura nr.17-210-001-236 datë 03.06.2017, fatura nr.17-210-001-155 datë 20.04.2017, Fatura 17-210-001-260 data 13.06.2017, Fatura 17-210-001-270 data 20.06.2017, Fatura 17-210-001-280 data 27.06.2017, Fatura 17-210-001-290 data 03.07.2017, Fatura 17-210-001-294 data 05.07.2017, Fatura 17-210-001-302 data 13.07.2017, Fatura 17-210-001-345 data 08.08.2017, Fatura 17-210-001-349 data 10.08.2017, Fatura 17-210-001-351 data 11.08.2017, Fatura 17-210-001-356 data 12.08.2017, Fatura 17-210-001-364 data 17.08.2017, Fatura 17-210-001-411 data 21.09.2017, Fatura 17-210-001-414 datë 22.09.2017, Fatura 17-210-001-548 data 04.12.2017, Fatura 17-210-001-18 data 19.03.2018, Fatura 17-210-DPR-18 data 07.03.2019, Fatura 17-210-DV-128 data 21.09.2017, Fatura 17-210-DV-115 data 21.08.2017, për shumën e përgjithshme prej 2,835.25€.

Përmbartuesi privat Rrezarta Metaj, me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit ka lëshuar urdhër me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm – faturave të lartcekura- të cilat paraqesin dokumente përmbartuese në bazë të nenit 21 dhe nenit 29 par.1.3 të LPP-së.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit, brenda afatit ligjor, prapësim ka paraqitur debitori, duke kundërshtuar propozimin e kreditorit si të pabazuar, me arsyetimin se shumica e faturave nuk janë të nënshkruara nga debitori dhe si rezultat të njëjtat asnjëherë nuk janë pranuar, andaj në prani të këtyre rrethanave konsiderojmë se pasi që të njëjtat nuk janë pranuar nga ana e debitorit, të njëjtat nuk përmbajnë elementet e dokumentit të besueshëm siç është paraparë sipas LPP-së.

Në përgjigjen në prapësim kreditori kundërshton pretendimet në prapësim, se nuk janë dhënë asnjë arsye të cilat janë paraparë me dispozitën e nenit 71 të LPP-së, faturat janë të përshtatshme për përmbarim, i propozon gjykatës që ta refuzoj si të pathemeltë prapësimin e debitorit dhe ta lë në fuqi urdhrin përmbarimor P,nr.387/18 dt.04.06.2018 të lëshuar nga përmbaruesi privat.

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil me aktvendimin PPP.nr.725/18 të datës 31.10.2018, e ka Refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit “Candeo” L.L.C me seli në Prishtinë, i ushtruar kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit numër P.nr.387/18 të datës 04.06.2018 të lejuar nga Zyra Përmbarimore – përmbaruesi privat Rrezarta Metaj në Prishtinë. Në arsyetim të aktvendimit gjykata vlerëson se faturat e bashkangjitura urdhrin përmbarimor janë dokumente të besueshme dhe të përshtatshme për përmbarim dhe përbëjnë bazë juridike për caktimin e përmbarimit ngase i kanë plotësuar kushtet ligjore nga neni 27 dhe 29 i LPP-së.

Nga një vërtetim i tillë i gabuar i gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së, nga gjykata e shkallës së parë, e cila fare nuk është lëshuar në elementet vendimtare të dokumentit të besueshëm-autentik faturave bashkangjitur propozimit për përmbarim, Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerësoi se për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, në rastin konkret nuk është aplikuar drejt ligji, sepse nuk kemi një dokument të besueshëm dhe të përshtatshëm që i plotëson kushtet ligjore nga neni 21 dhe 29 të LPP-së. Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerësoi se në shkresat e lëndës nuk ka prova se faturat përmbarimore të lëshuara nga kreditori, janë të pranuar apo vulosura nga debitori.

Udhëzimi administrativ nr.15/2010 par Zbatimin e Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, neni 20 par.1 nënpar.1.17 parasheh që: *“Në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruajë faturën tatimore”*, e që në rastin konkret faturat për të cilën kreditori kërkon përmbushjen e detyrimit, nuk ka prova se është e pranuar nga debitori, të njëjtat nuk janë të vulosur nga ana e tij, në mënyrë që të konsiderohet si dokument i besueshëm. Kjo gjykatë nga

shkresat e lëndës, duke u referuar edhe në pretendimet ankimore, vërteton se disa prej këtyre faturave janë në kopje, dhe në anën tjetër të gjitha faturat përmbajnë vetëm një nënshkrim si dëshmi se faturat janë pranuar nga debitori, mirëpo kjo mënyrë e pranimi të faturës që pretendon kreditori, vetëm me një nënshkrim për të cilin nuk dihet se debitori apo personat e autorizuar të tij kanë nënshkruar faturat, nuk mund të konsiderohet si dokument i besueshëm dhe i përshtatshëm për tu realizuar procedura përmbartimore nga neni 21, 36 par.1 dhe 37 të LPP-së që parashohin:

*21.Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.*

*36.1Së bashku me propozimin për përmbartim, organit përmbartues i dorëzohet edhe dokumenti përmbartues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbartueshmëris për përmbartueshmëri.*

*37.Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.*

Meqë kreditori nuk ka dëshmuar me asnjë provë tjetër se faturat përmbartimore janë pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, Dhomat e shkallës së dytë, nuk e ka pranuar si të drejtë përfundimin e gjykatës së shkallës së parë se faturat e kreditorit është dokument i besueshëm i lejuar për përmbartim. Nga këto arsye, Gjykata Komerciale –Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson ndryshe gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe gjen se në rastin konkret plotësohen kushtet ligjore që aktvendimi i ankimuar të ndryshohet, të pranohet prapësimi i debitorit si i bazuar dhe të shfuqizohet Urdhri për lejimin e përmbartimit nga ana e Përmbartuesit privat Rrezarta Metaj në Prishtinë, P.nr.387/18 datës 04.06.2018.

Dhomat e shkallës së dytë nuk mund ta pranoj qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë, për faktin se kjo e fundit gabimisht ka nxjerr konstatimin se faturat janë dokumente të besueshme, duke mos vërtetuar faktet vendimtare, në këtë rast se faturat nuk i plotësojnë të gjitha kushtet ligjore për tu konsideruar dokument i përshtatshëm dhe i besueshëm nga neni 37 i LPP-së. Kjo gjykatë vlerëson se faturat mbi të cilat është caktuar urdhri për lejimin e përmbartimit nuk mund të jenë të pambarueshme pasi që nuk janë pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, dhe në këtë rast konsiderohet se debitori nuk e ka pranuar borxhin e pretenduar nga kreditori.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë, për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë, bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208, 209 pika (c) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së dytë

K.Dh.Sh.II.nr.74/24 datë 21.02.2024

Gjyqtari,  
Krenar Berisha